

**Informacion përmbledhës mbi projektet me financim nga donatorë të huaj
dhe bashkëfinancim nga qeveria shqiptare**

❖ **Titulli i projektit: “Projekti i Shërbimeve Mjedisore”**

Financuesi: IBRD, GEF, SIDA, MTM
Kosto totale: 16,215, 000 Euro
Kohëzgjatja: Janar 2015-Dhjetor 2019

Objekti i projektit të Shërbimeve Mjedisore (ESP) është të mbështesë praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe rritjen e përfitimeve monetare dhe jo-monetare për komunitetet në zona të caktuara të Projektit, të cilat shtrihen kryesisht në zona të ngritura rurale të prekshme nga erozioni.

Komponentët e Projektit:

- Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peisazhit që përfshin:
 - (i) përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve;
 - (ii) krijimin e Sistemit shqiptar të Informimit për Pyjet;
 - (iii) regjistrimin e pyjeve dhe kullotave që i janë transferuar komunave nga qeveria qendrore;
- Planifikimi dhe Ofrimi i Nëngranteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës që përfshin realizimin e aktiviteteve për të përgatitur dhe zbatuar Planet Komunale për Mikrobaset për përmirësimin e menaxhimit të tokës dhe dhënien e Granteve për përfituesit që plotësojnë kriteret (Individët, Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale);
- Prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore nëpërmjet përgatitjes së studimeve teknike për zhvillimin e projekteve të karbonit dhe zhvillimit të mekanizmave për pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit për t’u siguruar se ata që përfitojnë nga shërbimet mjedisore i paguajnë prodhuesit e këtyre shërbimeve; dhe zhvillimin e një modeli për lidhjen e praktikave të përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemit.
- Mbështetja për Zbatimin e Projektit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve duke përfshirë furnizimin me pajisje zyre, ndërtimin e kapaciteteve të stafit dhe zbatimin e garancive mjedisore.

❖ **Titulli i projektit: “Forcimi i kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e Natyrës - NATURA 2000”- IPA 2013**

Financuesi: Bashkimi Evropian, MTM
Kosto totale: 4,400,000 milion Euro
Kohëzgjatja: 2015-2018

Objektivi i projektit: Synon ndalimin dëmeve dhe humbjen e Biodiversitetit në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura në vend.

Komponentët e projektit janë:

- a. Implementimi i të paktën 5 Planeve ekzistuese të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura.
- b. Përgatitja e një liste paraprake të vendeve të mundshme për rrjetin Natura 2000 për të gjithë vendin.
- c. Inventar *on-site*.
- d. Hartimi i fishave të projekteve për fushën e biodiversitetit.

❖ **Titulli i projektit: “Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën- IBECA”- IPA 2013**

Financuesi: Bashkimi Evropian, MTM
Kosto totale: 1,990,000 Euro
Kohëzgjatja: 2015-2018

Objektivi i projektit: Të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes kërkesave dhe menaxhimit më të mirë të mjedisit dhe klimës duke bërë të mundur që institucionet shtetërore të zhvillojnë, zbatojnë dhe detyrojnë standardet e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën.

Komponentët e projektit janë:

- Komponenti A: Rritja e efektivitetit të strategjisë së mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike përmes hartimit dhe zbatimit të planit sektorial dhe transpozimit dhe zbatimit të akteve prioritare të legjislacionit evropian për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.
- Komponenti B: Përmirësimi i inspektimit, detyrimit dhe ndjekjes penalisht të shkeljeve të legjislacionit për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.
- Komponenti C: Përmirësimi i menaxhimit të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në nivel qendror e lokal.

❖ **Titulli i projektit: “Asistencë teknike në fushën e mbetjeve IPA 2013”**

Financuesi: Bashkimi Evropian, MM
Kosto totale: 2,200,000 milion Euro
Kohëzgjatja: 2017-2020

Qëlimi kryesor i projektit është dhënia e asistencës teknike dhe përmirësimi i kapaciteteve kombëtare dhe lokale për menaxhimin e integruar të mbetjeve për dy rajone kryesore në vend; Gjirokastrë dhe Kukës, me studime fisibiliteti në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të zhvillojë një mjedis më të pastër dhe më të sigurt për qytetarët në Shqipëri.

❖ **Titulli i projektit: “Wetmain Areas - Përmirësimi i Efikasitetit të Mbrojtjes së Ligatinave”**

Për këtë projekt përfitues është Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Projekti është në kuadër të Programit të Bashkëpunimit `Interreg V- Balkan Mediterranean 2014-2020`.

Projekti do të ketë këtë kohëzgjatje 2017 - 2019. Vlera totale për gjithë partnerët (8 partnerë total) - 1,159,383.93 Euro. Buxheti i AKM në cilësinë e partnerit zbatues: 122,574.00 Euro (përfshirë këtu pjesën e bashkë- financimit).

Projekti do të bëjë inventarizimin kombëtar të ligatinave dhe pasurive natyrore të tyre, vlerësimin e shkallës së ndërveprimit të faktorëve të ndryshëm me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e statusit të tyre të mbrojtjes. Projekti do të ofrojë të dhëna dhe analiza të politikave aktuale kombëtare në fushën e ligatinave.

❖ **Titulli i projektit: “Dokumenti për Planifikimin e Sektorit të Ujit - SPD”**

Financuesi: IPA, MTM
Kosto totale: 4, 400, 000 Mln Euro (për të gjithë përfituesit).
Kohëzgjatja: 2018 – 2020

Projekti financohet nga IPA II. Përfitues të këtij projekti do të jenë të gjitha ministritë e linjës/agjencitë të cilat ushtrojnë funksione në politikbërjen për sektorin e ujit dhe nënfushat e tij.

Objektivi kryesor është të sigurohet që sektori i ujit të menaxhohet në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme, në përputhje me politikën dhe legjislativën e BE-së. Në mënyrë që të arrihet ky objektivi, janë përzgjedhur dy fusha kryesore prioritare, përkatësisht menaxhimi i integruar i ujit dhe trajtimi i ujërave të zeza.

Dokumenti i veprimit për asistencën për sektorin e ujit është hartuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (AKM, përgjegjëse për monitorimin e ujit, do të jetë përfituese direkte e kësaj asistence teknike).

Komponentët kryesorë të projektit janë:

- Të forcojë kapacitetet për menaxhimin e integruar të ujit.
- Të forcojë menaxhimin e ujërave të zeza dhe kapacitetet që ofrojnë shërbim.



Titulli i projektit: “Ruajtja dhe Përdorimi i Qëndrueshëm i Biodiversitetit në Liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës (Plan Rajonal për Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi)-CSBL II”

Financuesi: Qeveria Gjermane
Kosto totale: 3, 000, 000 Euro (për rajonin).
Kohëzgjatja: 2014 – 2017 faza e dytë
2018 – 2020 (pritet të përfundojnë procedurat ligjore për miratimin e fazës së tretë)

Projekti është rajonal, me tre përfitues; Shqipëri – Mal i Zi – Maqedoni. Objektivi i përgjithshëm është: Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit, rregulloreve dhe planeve të menaxhimit për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës në përputhje me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe të biodiversitetit të BE-së. Fokusi kryesor i masave të parashikuara janë aktivitetet e menaxhimit të burimeve ujore dhe peshkimit të qëndrueshëm, ndërsa ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike është themeluar kryesisht si një çështje ndërsektoriale.

Projekti do të përfshijë 4 fusha kryesore:

1. Bashkëpunimin Transnacional;
2. Direktiva e BE-së mbi Ujin;
3. Legjislacioni i BE-së mbi mbrojtjen e Natyrës dhe
4. Ruajtja dhe monitorimi mjedisor i biodiversitetit.

❖ **Titulli i Projektit: “Biosfera e Rezervatit të Prespës (II)”**

Financuesi: Qeveria Gjermane, Banka KfW, MTM
Kosto totale: 3,950,000 Euro
Kohëzgjatja: 2017 - 2020

Objektivi i projektit është të reduktojë presionin mbi burimet natyrore si edhe uljen e varfërisë në pjesën e Shqipërisë së Rezervës së Biosferës, Prespë. Ky objektivi do të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës të popullsisë në PNP dhe në pjesën shqiptare të Rezervës së Biosferës

Komponentët e projektit janë:

- i) Fillimin e aktivitetit të Biosferës Rezervë se miratur nga UNESCO;
- ii) Konsolidimi i aktivitetëve social – ekonomike;
- iii) Përmirësimi i mbrojtjes së aseteve të biodiversitetit në Parkun Kombëtar të Prespës;
- iv) Marrjen e masave për zbutjen e presionit dhe mitigimin e përdorimit pa kriter të tokës në Parkun Kombëtar të Prespës;
- v) Menaxhimi i projektit.

❖ **Titulli i projektit: “Ruajtja dhe Përdorimi i Biodiversitetit në zonat rurale në Shqipëri CABRA II”.**

Financuesi: Qeveria Gjermane
Kosto totale: 2, 000, 000 Euro
Kohëzgjatja: 2015 – 2017
2018 – (faza e tretë)

Fokusi kryesor i projektit është mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe agrobiodiversitetit në zonat e përzgjedhura malore të Shqipërisë (kryesisht rajoni i Alpeve).

Komponentët kryesore të projektit:

1. Mbrojtja e biodiversitetit dhe agrobiodiversitetit;
2. Rritja e të ardhurave në familjet rurale nëpërmjet përdorimit të balancuar, të qëndrueshëm dhe në balancë gjinore të burimeve natyrore;
3. Aplikimi i instrumenteve të rinj të politikave, procedurave dhe proceseve për mbrojtjen e biodiversitetit.

Ky projekt ka një fazë të re zbatimi, i cili ka një shtim në vlerën e kontributit financiar, në shumën 500,000 Euro dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2018.

Në këtë fazë objektivi i projektit fokusohet në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, të trashëgimisë gjenetike të biodiversitetit dhe agrobiodiversitetit në zonat e mbrojtura, me fokus Alpet e Shqipërisë, si dhe synon të konsolidojë rezultatet e arritura nga pilotimi për një territor.

Ky projekt trajton dhe kontribuon në disa nga prioritetet dhe objektivat e strategjisë së biodiversitetit dhe kapitullit përkatës në SKZHI deri në vitin 2020, si dhe njëkohësisht disa prioritete të strategjisë ndërsektoriale të bujqësisë, veçanërisht fermat organike dhe agromjedisin, diversifikimi i tyre, forcimi i grupeve të fermerëve, transferimi njohurive për kultivimin e racave dhe varieteteve lokale, zgjerimi i përdorimit të skemave të cilësisë, forcimi i kapaciteteve, për programet e EU LEADER, si programe që do të ndihmojnë në zhvillimin lokal duke rigjallëruar zonat rurale dhe duke mundësuar punësime të reja.

❖ **Titulli i projektit: “Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike në menaxhimin ndërkufitar të riskut në Ballkanin Perëndimor”.**

Financuesi: Qeveria Gjermane
Kosto totale: 2, 000, 000 Euro
Kohëzgjatja: 2016 –2018

Objektivi kryesor i këtij projekti rajonal është të mbështesë katër vendet perkatësisht Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Kosovën, dhe të përmirësojë menaxhimin ndaj riskut të përmbytjeve në basenet e lumit Drin.

Indikatorët e projektit janë si më poshtë:

- Parashikimet e përmbytjeve për basenet e lumit Drin të zhvillohen në mënyrë periodike;
- Vendosja e masave ndërkufitare për manaxhimin ndaj riskut të përmbytjeve;
- Të rritet me 20% numri i njerëzve që kanë njohuritë e nevojshme si të sillen në zonat e prekura nga përmbytjet.

❖ **Titulli i projektit: “Krijimi i sistemit të menaxhimit dhe monitorimit mjedisor në linjë me raportimet globale”**

Financuesi: GEF, MTM
Kosto totale: 1,070,000 USD
Kohëzgjatja: Nëntor 2015- Nëntor 2019

Objektivi kryesor i këtij projekti është të adresojë nevojën për një sistem të monitorimit të mjedisit të integruar në të gjithë institucionet relevante qeveritare dhe që përdor standardet

ndërkombëtare të monitorimit për mbledhjen e të dhënave, analizimin e tyre, dhe politikëbërjen në bazë të të dhënave.

Projekti do të përmirësojë kapacitetet ekzistuese teknike dhe institucionale në Shqipëri për të monitoruar dhe raportuar në konventat e Rio – CBD, UNCCD, UNFCCC.

Komponentët e projektit janë:

- Komponenti 1- Adresimi për një zgjidhje institucionale dhe IT për një monitorim të Integruar të Informacionit Mjedisor dhe Sistemit të Menaxhimit (EIMMS).
- Komponenti 2- Përditësimi i treguesve, bazës së të dhënave dhe synimeve.
- Komponenti 3- Ngritja e kapaciteteve për përdorimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit.



Titulli i projektit: “Arritja e përshtatjes së Lagunës Kune-Vaini përmes përqasjes së adaptimit të bazuar në Ekosistem” (EbA)

Financuesi: GEF, MTM
Kosto totale: 2,093,300 USD
Kohëzgjatja: 2016-2019

Objektivi kryesor i projektit është të forcojë kapacitetet qendrore dhe lokale për menaxhim sa më të mirë të lagunës së Kune-Vainit duke marrë në konsideratë ndikimin e ndryshimeve klimatike, problemet e erozionit, rreziqet ndaj faunës dhe florës. Gjithashtu projekti synon zhvillimin e disa masave të bazuara në ekosistem në lagunë.

Komponentët e projektit janë:

- Kapacitetet teknike dhe institucionale për të adresuar rreziqet e ndryshimeve klimatike përmes adaptimit në ekosistem (EbA);
- Ndërhyrje konkrete në lagunë për të bërë të mundur:
 1. Reduktimin e sedimentit,
 2. Rehabilitimin e dunave,
 3. Parandalimin e përmytjeve,
 4. Mbrojtjen dhe restaurimin e pellgut.
- Ndërgjegjësimi dhe njohja me vlerat e sistemit të Adaptimit të bazuar në Ekosistem (EbA).



Titulli i projektit: “ Rritja e qëndrueshmërisë financiare të sistemit të zonave të mbrojtura”

Financuesi: GEF
Kosto totale: 1,420,000 US \$
Kohëzgjatja: 2017-2020

Qëllimi i projektit është t'i vijë në ndihmë qeverisë shqiptare për zvogëlimin e mangësive ekzistuese të financimit për sistemin e zonave të mbrojtura, përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura të veçanta, përmirësimin e efikasitetit të kostove në zonat e mbrojtura individuale dhe ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese financiare të personelit të zonave të mbrojtura.

Komponentët e Projektit janë:

- Përmirësimi i planifikimit financiar dhe kapaciteteve të menaxhimit të sistemit të zonave të mbrojtura.
- Rritja e të ardhurave nga zonat e mbrojtura të veçanta.



Titulli i projektit: “Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit”

Financuesi: GIZ
Kosto totale: 3,000,000 Euro
Kohëzgjatja: 2016-2019

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, kryesisht duke pasur në konsideratë aspektet klimatike.

Projekti do të zhvillohet në nivel kombëtar ku përfshihen ministrinë, dhe në nivel lokal në 3 bashki partnere Himara, Peqini dhe Rrogozhina.

Fushat e ndikimit të projektit synojnë:

1. Të përmirësojë harmonizimin dhe koordinimin midis aktorëve të sektorit në nivel kombëtar dhe midis niveleve kombëtare dhe lokale.
2. Forcimin e kapaciteteve të autoriteteve të mbetjeve dhe sektorin privat në bashkitë partnere për futjen e një administrimi të integruar të mbetjeve dhe riciklimin.
3. Mbështetja e palëve të interesuara në bashkitë partnere për të përmirësuar pjesëmarrjen e publikut në sistemin e reformuar të menaxhimit të mbeturinave.

❖ **Titulli i projektit: “Energjia e Biomassës për përdorim prodhimi në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) në industrinë e vajit të ullirit”**

Financuesi: GEF, MTM
Kosto totale: 927,000 USD
Kohëzgjatja: 2016-2019

Projekti ka për qëllim të transformojë tregun për përdorimin e mbetjeve organike nga vaji i ullirit dhe industri të tjera për prodhimin e energjisë. Kjo synohet të arrihet përmes investimeve në industrinë e ullirit organik dhe industri të tjera të mbetjeve për projektet e energjisë, përmes demonstrimit të tregut, zhvillimin e instrumenteve përkatëse financiare, ngritjen e kapaciteteve, forcimin e politikave dhe mjedisit rregullator.

Projekti do të reflektojë prioritetet e qeverisë shqiptare për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, si pjesë anëtare e Komunitetit Europian të Energjisë, si dhe për të zbatuar legjislacionin Europian në Energjinë e Rinovueshme, i cili përcakton objektivat specifike të saj në energjinë e konsumit.

Komponentët e projektit:

- Përdorimi i teknologjive moderne të biomassës në proceset industriale në Shqipëri;
- Mundësimin e Tregut dhe mjedisit rregullator për teknologjinë e biomassës në industrinë e krijuar në Shqipëri;
- Menaxhimi i Monitorimit, Vlerësimit dhe njohurive.

